

V E N D I M
Nr. 364, datë 14.7.2000

**PËR TRAJTIMIN E PUNONJËSVE, QË SHKURTOHEN NGA ZBATIMI I
MARRËVESHJES SË KONCESIONIT, PËR UZINËN E FERROKROMIT,
ELBASAN DHE PËR MINIERAT E KROMIT PËRRENJAS DHE POJSKË**

(Ndryshuar me VKM nr. 59, datë 2.2.2001)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.8562, datë 22.12.1999, “Për përcaktimin e formës dhe strukturës së formulës së privatizimit të shoqërive anonime “Albkrom”” dhe të ligjit nr.8590, datë 23.3.2000, “Për miratimin e marrëveshjes së koncensionit, të formës “BOT”, për Uzinën e Ferrokromit, Elbasan, dhe për minierat e kromit Përrenjas e Pojskë, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe shoqërisë italiane DARFO, s.p.a., për dhënien e disa stimuljeve dhe garancive për koncensionarin e kësaj marrëveshjeje”, me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Punonjësve që dalin të tepërt, si pasojë e zbatimit të marrëveshjes së koncensionit, për Uzinën e Ferrokromit, Elbasan dhe për minierat e kromit Përrenjas dhe Pojskë, t’u jepet një shpërblim i barabartë me pagën e 2 (dy) viteve. Si pagë do të merret paga mujore bazë dhe vjetërsia në punë, që kanë patur në çastin e shkëputjes nga puna.

2. *Fondet financiare, prej 129 milionë lekësh, të nevojshme për shpërblimin e 398 punonjësve të Uzinës së Ferrokromit, Elbasan, të minierave të kromit, Përrenjas dhe Pojskë, dhe të administratës së “Albkrom”, sh.a., që kanë mbuluar këto njësi e që do të trajtohen sipas këtij vendimi, të përballohen nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.*

a) *Për vitin 2000, shumën 64.5 milionë lekë, me fondet e dhëna nga koncensionari dhe nga fitimi i “Taulantia”, sh.a, të vitit 2000, në shumën 36.3 milionë lekë.*

b) *Për vitin 2001 shumën 64.5 milionë lekë, nga fondet e dhëna nga koncesionari, 200 000 USD, dhe diferenca nga fondet e krijuara, në zbatim të vendimit nr.416, datë 9.7.1998, të Këshillit të Ministrave, “Për administrimin dhe përdorimin e të ardhurave të Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, nga privatizimi i shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë.*

3. *Përfitojnë nga ky vendim punonjësit e Uzinës së Ferrokromit, Elbasan, të minierave të kromit, Përrenjas dhe Pojskë, dhe të administratës së “Albkrom”, sh.a., që kanë mbuluar këto njësi, të cilët kanë qenë të punësuar pranë tyre, pa ndërprerje, që nga 1.6.1999 e deri më datën 19.7.2000, data e hyrjes në fuqi e këtij vendimi*

4. Shpërblimi i punonjësve që dalin të tepërt nga zbatimi i marrëveshjes së koncensionit për Uzinën e Ferrokromit, Elbasan dhe për minierat e kromit Përrenjas dhe Pojskë, do të bëhet nga sh.a., “Albkrom”, me 4 (katër) kështe, të barabarta, në çdo 6 muaj. Kësti i parë do të jepet në muajin korrik 2000.

5. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta